



Data: 22.02.2019

Ref.: 317113 Q

Në mbështetje të nenit 4, dhe nenit 23 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 61-të, të mbajtur më 15 dhe 16 janar 2019, mori:

V E N D I M

I. Refuzohet kërkesa e Kolegjit Fama, (Nr.1493/18H, datë 31.10.2018) për akreditim të programeve të studimit si më poshtë:

- Laborant Dentar, BSc, 180 ECTS;
- Laborant Mjekësor, BSc, 180 ECTS; dhe
- Stomatologji, Dr. Dent, 300 ECTS.

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Kolegji Fama ka parashtruar kërkesë (Nr.1493/18H, datë 31.10.2018) në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për riakreditim të programeve të studimit si në vijim: Laborant Dentar, BSc, 180 ECTS; Laborant Mjekësor, BSc, 180 ECTS, Stomatologji, Dr. Dent, 300 ECTS, dhe Menaxhment, MA, 120 ECTS.

Bazuar në nenin 10 të Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Nr. 15/2018, datë 28.09.2018, (tash e tutje UA për Akreditim), KShC në mbledhjen e mbajtur me 15 dhe 16 janar 2019 ka trajtuar aplikacionin e Kolegjit Fama. Në pikën 1.2 të nenit 10 të UA për Akreditim, thuhet, *"Në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi administrativ, KShC do të bëjë aprovimin e listës së stafit akademik për çdo program të studimit i cili parashtrohet për aplikim nga institucionet e arsimit të lartë. Tabelat e plotësuara në formë elektronike se bashku me deklaratat për angazhimin e stafit akademik përcillen në formë të raportit përmbledhës në mbledhjen e ardhshme të KShC-së për aprovim formal. Raporti përmbledhës për gjendjen e stafit në bazë të të dhënave të dorëzuara nga institucionet e arsimit të lartë përgatitet nga stafi i AKA-së"*.

Mbi këtë bazë, KShC erdhi në përfundim se programet e studimit të Kolegjit Fama, Laborant Dentar, BSc, 180 ECTS; Laborant Mjekësor, BSc, 180 ECTS, Stomatologji, Dr. Dent, 300 ECTS, nuk i plotësojnë kushtet ligjore për aprovim të aplikacionit.

Sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018): *“Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”.*

Bazuar në nenin e referuar më sipër KShC ka verifikuar te gjithë dokumentacionin relevant të kualifikimit të stafit akademik për programet e studimit. Këto te dhëna janë prezantuar në mbledhjen e KShC-së të mbajtur me 15 dhe 16 janar 2019, dhe pas shqyrtimit të dosjes për secilin staf akademik, KShC mori vendim që të refuzojë aprovimin e aplikacioneve të Kolegjit Fama, sipas pikës një të dispozitivit të këtij vendimi.

1. **Për programin e studimit: Laborant Dentar, BSc, 180 ECTS**, Kolegji Fama ka paraparë këta person si bartës të këtij programi të studimit: Ali Gashi, Halil Ajvazi, dhe Afrim Gashi.

Sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: *“Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”.*

Ky program ka 180 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit Kolegji Fama, duhet te ketë të paktën tre anëtarë të stafit akademik me gradën shkencore *PhD* me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit.

Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga Kolegji Fama për këtë program të studimit, u konstatua që Halil Ajvazi (PhD në Sëmundjet e Syrit) dhe Afrim Gashi (PhD në Shkencat e Mjekësisë) nuk i plotësojnë kushtet e kërkuara sipas nenit të referuar më lartë (26, 5.3.4).

Për më tepër, sipas nenit 30 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim, *“IAL-të, duhet të dorëzojnë deklaratat e stafit akademik të angazhuar jo me larg se data 31 tetor”*, pra Kolegji Fama ka qenë i detyruar që të deklarojë stafin akademik më së largu deri më 31 tetor 2018. Njëri nga bartësit e këtij programi, përkatësisht Afrim Gashi nuk është i deklaruar për angazhimin e tij si staf akademik në këtë institucion, sipas afateve të parapara me UA për Akreditim. Mbi këtë bazë i njëjti nuk mund të jetë bartës i këtij programi të studimit.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara me lartë, dhe në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit, dhe bazuar në nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, KSHC erdhi në përfundim që ky program i studimit nuk i plotëson kushtet ligjore për aprovim, dhe mbi këtë bazë, vendosi ta refuzojë aprovimin e aplikacionit për programin e studimit, *Laborant Dentar, BSc, 180 ECTS*.

2. Për programin e studimit: *Laborant Mjekësor, BSc, 180 ECTS*, Kolegji Fama ka paraparë këta persona si bartës të këtij programi të studimit: Sabri Hajdini, Ilir Ahmetxhekaj, dhe Islam Zeqiri.

Sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018): *"Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit"*.

Ky program ka 180 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit Kolegji Fama, duhet të ketë të paktën tre anëtarë të stafit akademik me gradën shkencore *PhD* me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit.

Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga Kolegji Fama për këtë program të studimit, u konstatua që asnjëri nga bartësit e programit të prezantuar në këtë program të studimit, nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë bartës i programit të studimit. Sabri Hajdini është *PhD* në Teknologjia dhe Mikrobiologjia e Ushqimeve, vlerësimi i Sigurisë dhe Cilësisë, fushë kjo e cila nuk përkon me programin e studimit *Laborant Mjekësor*. Ilir Ahmetxhekaj sipas dëshmive të cilat posedon AKA, ka deklaruar që ka marrëdhënie të rregullt të punës në Kolegjin UBT, dhe jo në Kolegjin Fama, dhe i njëjti nuk mund të jetë bartës i programit të studimit në Kolegjin Fama. Ndërsa Islam Zeqiri ka gradën shkencore *MA*, dhe i njëjti bazuar në nenin 26, pika 5.3.4 e UA për Akreditim (Nr.15/2018, datë 28.09.2018) nuk mund të jetë bartës i këtij programi të studimi, pasi që sipas kësaj pikë për çdo program, bartësit duhet të kenë gradën shkencore *PhD* nga fusha e programit të studimit. Mbi këtë bazë i njëjti nuk mund të jetë bartës i këtij programi të studimit.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, dhe në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit, dhe bazuar në nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, KSHC erdhi në përfundim që ky program i studimit nuk i plotëson kushtet ligjore për aprovim, dhe mbi këtë bazë, vendosi ta refuzojë aprovimin e aplikacionit për programin e studimit *Laborant Mjekësor, BSc, 180 ECTS*.

3. Për programin e studimit: *Stomatologji, Dr. Dent, 300 ECTS*, Kolegji Fama ka paraparë këta persona si bartës të këtij programi të studimit: Xhevdet Aliu, Feim Mazreku, Ali Lahu, Vjosa Mulliqi Kotori, dhe Skender Zatriqi.

Sipas nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018): *"Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit"*.

Ky program ka 300 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit Kolegji Fama, duhet të ketë të paktën pesë anëtarë të stafit akademik me gradën shkencore *PhD* me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit.


Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga Kolegji Fama për këtë program të studimit, u konstatua që katër nga pesë bartësit e programit të prezantuar nga Kolegji Fama, nuk janë të fushës së programit të stomatologjisë. Feim Mazreku është PhD në Lëndët Klinike, Ali Lahu është PhD në Lëndët Paraklinike, Vjosa Mulliqi Kotori është PhD në Biomjekësi dhe Shkenca shëndetësore, dhe Skender Zatriqi është PhD në Shkencat e Mjekësisë.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, dhe në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit (bazuar në nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim), KSHC erdhi në përfundim që ky program i studimit nuk i plotëson kushtet ligjore për aprovim, dhe mbi këtë bazë, vendosi ta refuzojë aprovimin e aplikacionit për programin e studimit *Stomatologji, Dr. Dent, 300 ECTS*.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (Nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji "Fama";
- MASHT-it;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

